**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E BUJQESISE, USHQIMIT DHE MBROJTJES SE KONSUMATORIT**
**DREJTORIA VETERINARISE**

Nr 8572 Prot

Tirane me 14.11.2005

## URDHER

## PER NDALIMIN E IMPORTIT TE SHPENDEVE TE GJALLA TE SKARTIMIT NE KUADER TE FUQIZIMIT TE MASAVE PER MBROJTJEN E KONSUMATORIT

Mbeshtetur ne nenin 102, pika 4 e Kushtetutes se Republikes se Shqiperise;
Mbeshtetur ne nenin 21, pika 2 dhe nenin 85, te Ligjit Nr. 9308 dt. 04.11.04 "Per Sherbimin dhe Inspektoriatin Veterinar";
Mbeshtetur ne ne nenin 42, pika 4, te Ligjit Nr. 9308 dt. 04.11.04 "Per Sherbimin dhe Inspektoriatin Veterinar";
Mbeshtetur ne Rregulloren nr. 2, dt. 22.06.1993, "Per mbrojtjen e Republikes se Shqiperise nga hyrja dhe dalja e semundjeve ngjitese te kafsheve dhe kontrollit veterinar te produkteve blegtorale ne doganat e qyteteve";

## URDHEROJ:

1. Ndalimin e importit te shpendeve te gjalla dhe produkteve te tyre nga cilido vend ku shfaqet Influenca Aviare (Gripi i Shpendeve).
2. Ndalimin e importit te shpendeve te gjalla te skartimit nga cdo vend deri ne nje kohe te pacaktuar, per arsye te mungeses se infrastruktures perkatese dhe realizimit te therjes se tyre brenda 72 oreve nga koha e futjes ne territorin e Republikes se Shqiperise (neni 42, pika 4 e ligjit "Per Sherbimin dhe Inspektoriatin Veterinar).
3. Lejimin e importit te shpendeve te skartimit ne formen e produktit te therur, perpunuar e marketuar sipas kushteve standart per konsum publik.
4. Lejimin e importit te zogjve 24 oresh, zogave te remontit te moshes deri 115 diteshe, para fillimit te pjelljes dhe zogjve brojler deri 35 ditesh, me kusht qe subjektet importuese te kene infrastrukturen perkatese te miratuar nga sektori veterinar i qarkut ku ushtron aktivitetin.
5. Urdheri Nr 3117 date 13.10.2005 shfuqizohet.
6. Me zbatimin e ketij Urdheri ngarkohen : Drejtoria e Veterinarise, Sektoret Veterinare te qarqeve, Zyrat Veterinare vendore ne bashki e komuna dhe Pikat e Inspektimit kufitar
7. Ky Urdher hyn ne fuqi menjehere

**MINISTRI**

**JEMIN GJANA**